



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA RREGULLATORE**  
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

Nr. 9927 prot.

Vlorë, më 10.06 2025

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**PËR**

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
DJEGIA E BANESËS TË Z.THODHORI BOLLANO DHE SHPËRBLIMIN  
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Theodhori Bollano, e ndodhur në lagjen “29 Nëntori”, Rajoni Nr3, Bashkia Vlorë, në datën 18.02.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 36.726 (tridhjet e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekë për punime ndërtimi (73.453x50%).

B. 212.060(dyqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëdhjet) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORE**  
**DREJTORIA RREGULLATORE**  
**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE**

Nr. 9927 prot.

Vlorë, më 2006 2025

**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN "MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.THODHORI BOLLANO DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORE "**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", në Bashkinë Vlorë datë 27.02.2025 ka paraqitur kërkesën z.Thodhori Bollano me nr.3244prot. për shkak të djegies së banesës në datën 18.02.2025 e ndodhur në lagjen "29 Nëntori", Rajoni Nr3, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.26 datë 24.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 28.02.2025, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.3244/1 prot, datë 09.04.2025 "Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Thodhori Bollano në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.3244/2 prot, datë 28.05.2025 "Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Thodhori Bollano ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Thodhori Bollano është 248.786 (dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjet e gjashtë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Thodhori Bollano sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

**DREJTOR**

**Dorian Demiri**

